



|                                                                                                                                                                                                   |          |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO<br>QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVO-GOVERNMENT OF KOSOVO                                                                                                     |          |
| MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË<br>MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE<br>MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY<br>SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR |          |
| Njesia Org.<br>Org. Jedinica<br>Org Unit                                                                                                                                                          | 5        |
| Nr. i faqeve<br>Br. stranica<br>No. pages                                                                                                                                                         | 2        |
| Nr. Prot.<br>Broj Prot.<br>Prot. No.                                                                                                                                                              | 448      |
| Data:<br>Datum<br>Date                                                                                                                                                                            | 24.06.22 |
| Prishtine / e                                                                                                                                                                                     |          |

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada-Government**

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit*  
*Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,*  
*Technology and Innovation*

Datë: 24.06.2022  
Nr. 5-448

Komisioni për licencimin e BPrAL / Kolegjeve Private, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 dhe në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit Administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesës nr. 448 të datës 04.03.2022, të parashtruar nga BPrAL-Kolegji “Pjetër Budi” dhe mori këtë :

**V E N D I M**

1. Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - Kolegji “Pjetër Budi”, me seli në Prishtinë për periudhën dy vjeçare, 1 tetor 2022 deri më 01 tetor 2024.
2. Licenca i lëshohet vetëm për dy vite akademike, duke mos llogaritur vitin akademik 2021/22.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**A r s y e t i m**

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për licencim e BPrAL-ve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 448 datë 04.03.2022 të parashtruar nga Kolegji “Pjetër Budi”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriterët ligjore për licencim.

Licenca e këtij Institucioni Privat të Arsimit të Lartë zgjat dy vite akademike sipas vendimit të Agjencionit të Kosovës për Akreditim, duke mos llogaritur vitin akademik 2021/22, për shkak që Kolegji “Pjetër Budi”, është vlerësuar nga Komisioni për licencim i BPrAL, se nuk i plotëson kushtet për licencim, sepse i njëjti institucion në të njëjtin objekt/hapësirë është licencuar për “ushtrimin e veprimtarisë aftësuese për nivelin II (dy), III (tre) dhe IV (katër) sipas vendimit nr. 01-326 datë 31.05.2019 të AKK për programet” sipas pikave 1.1; 1.2; 1.3.

Andaj, pas dorëzimit të dëshmime nga Kolegji "Pjetër Budi", se kualifikimet të përmendura më lartë, ju skadon akreditimi me datë 21.05.2022, dhe nuk do të ushtron këtë veprimtari aftësuese për nivelin II (dy), III (tre) dhe IV (katër) sipas vendimit nr. 01-326 datë 31.05.2019 të AKK, në të njëjtin objekt/hapësirë, por vetëm për nivelin BA dhe MA, të Arsimit të Lartë.

Me datë 04.03.2022 nr. 448, ka ripërsëritur kërkesën për licencim, për vitet vijuese 2022 deri 2024.

Komisioni për Licencim i MASHTI –it duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në dokumentacion, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshillë Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi te Sekretari i Përgjithshëm i MASHTI-të.

#### **Vendimi u dërgohet:**

1. Parashtruesit të kërkesës,
2. Komisionit për licencim,
3. Sekretarit të Përgjithshëm,
4. Inspektoratit të Arsimit,
5. DALSHT,
6. Arkivit

Kryetar i Komisionit

**Burim Gashi**

